



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:047840

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06101771

KA.nr. 1163/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Wallingford International Kosovo” SH.P.K, me NRB 810818255, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Av. Arbresha Qenaj, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Adresa. Rr. Armend Daci nr. 110000 Prishtine, përfaqësuar nga Pleurat Gjata kundër Vendimit me Nr. Prot:408 të datës 23.02.2022 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në seancë publike më datë 22.08.2024, më datë 28.08.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Wallingford International Kosovo” SH.P.K, me NRB 810818255, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me të cilën ka kërkuar të anulohet Vendimi me Nr. Prot:408 të datës 23.02.2022 dhe të aprovohet kërkesa e paditësit për mbajtjen e licencës hulumtuese 1860/KPMM/2018 të datës 27.08.2020, si e pa bazuar.
- II. Hiqet masa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar e vendosur sipas aktvendimit te datës 23.05.2022.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 11.03.2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësit “Wallingford International Kosovo” SH.P.K, me NRB 810818255, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Av. Arbresha Qenaj, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Adresa. Rr. Armend Daci nr. 110000 Prishtine, me kërkesëpadi për anulimi të Vendimit me Nr. Prot:408 të datës 23.02.2022 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me propozim që të aprovet kërkesëpadi e paditësit si e bazuar te anulohet vendimi i kundërshtuar dhe të aprovet kërkesa e paditësit për mbajtjen e licencës hulumtuese 1860/KPM/2018 e datës 27.08.2020. Lënda është evidentuara me nr. A.536/20.
2. Me aktvendim te Gjykatës se Apelit AA nr.372/22 me date 23.05.2022 është vendosur të shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurës deri në shqyrtim përfundimtar lidhur me padinë e paditësit.
3. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 1163/22.
4. Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancë të shqyrtimit gjyqësor me datë 22.08.2024 në seancë publike me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, Jeton Berisha avokat nga Ferizaj, Arbresha Qenaj, sipas autorizimit të datës 09.03.2020 dhe me pjesëmarrje të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur nga KPM, Pleurat Xhata, sipas autorizimit të datës 22.08.2024.

Pretendimet e paditësit

5. Përfaqësues i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna në padi dhe deklarimeve ne seancë ka deklaruar se vendimi nr. 408 të datës 23.02.2022 me anë të cilit është refuzuar Kërkesa për Mbajtjen e Licencës së Hulumtimit numër 1860/KPM/2018 është në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1.1 të Ligjit për Miniera dhe Minerale (03L-163) ku parashihet

afati në kohëzgjatje prej një viti nga data e skadimit të Licencës së Hulumtimit. Pretendimet e dhëna në përgjigje në padi nga ana e të paditurit ku është theksuar se neni 26 parasheh se mbajtja e licencës së hulumtimit mund të mbahet më së shumti maksimum 1 vit pas skadimit pa shkëputje në këtë rast nuk qenë e mundur për shkaqe objektive janë të pabazuara. Deklaron se nuk ka pasur bazë ligjore për mbajtjen e licencës së hulumtimit në kuptim të nenit 26 të LMM-së, por arsyeja e refuzimit të kërkesës për mbajtjen e licencës së hulumtimit ka qenë mungesa e bordit. Kjo dëshmohet qartë edhe në vendimin nr. 408 datë 23.02.2022, ku KPMM në arsyetim të vendimit thekson shprehimisht se duke pasur parasysh se sipas nenit 26 par 1, mbajtja e licencës ka kohëzgjatje maksimale edhe për një vit pas kalimit të afatit të licencës i cili afat ka kaluar pa u shqyrtuar kërkesa kjo për mungese të bordit. Paditësi thekson se është jashtë vullnetit të aplikuesit për mbajtje të licencës që të formoj bordin që të shqyrtoj kërkesën dhe të nxjerrë vendime për aprovim apo refuzim për mbajtje të licencës. Pra skadimi i kohëzgjatjes së afatit në asnjë rrethanë nuk mund t'i ngarkohet paditësit, i cili ka përgatitur të gjitha dokumentet dhe ka aplikuar brenda afatit ligjor. Ndër të tjera ashtu siç i padituri është në dijeni për zonën ku paditësi ka licencën e hulumtimit nr. 1860/KPMM/2018, pas refuzimit me arsyetim të mungesës së bordit kanë aplikuar disa kompani të tjera me çka i është rrezikuar interesi dhe e drejta e paditësit. Paditësi, nisur nga arsyetimi i vendimit kontestues nr. 408 datë 23.02.2022 dhe thëniet e paditurit se është në diskrecion të KPMM-së, të vendos që të lejoj mbajtjen e licencës apo jo ka krijuar bindjen se pas trajtimit të dokumenteve dhe kërkesës për mbajtjen e licencës është udhëhequr nga anshmëria, jo objektiviteti dhe diskriminim i palës në procedurë. Prandaj i propozon Gjykatës që të aprovoj kërkespudinë si të bazuar, të anulohet vendimi dhe të aprovohet kërkesa e paditësit për mbajtjen e Licencës së Hulumtimit 1860/KPMM/2018, të datës 27.08.2020.

Kundërshtimet e të paditurës

6. Përfaqësuesi e autorizuar e palës së paditur Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Pleurat Xhata, në përgjigje në padi dhe në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë si të pabazuar, i propozon Gjykatës ta refuzoj padinë e paditësit kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale si të pabazuar dhe Vendimi K Vendimit me Nr. Prot:408 të datës 23.02.2022 i lëshuar nga KPMM të mbetet në fuqi.

7. Ka deklaruar se Bordi i KPMM-së ka vendos të refuzoj kërkesën për mbajtje të licencës të hulumtimit me numër 1860/KPMM/2018 për shkak se ka konstatuar se e njëjta nuk është në pajtim me nenin 26 par 1.1 LMM-së, i cili përcakton se KPMM mund të lëshoj një licencë të përmbajtjeve të të drejtave një personi i cili mban një licencë aktuale dhe të vlefshme të hulumtimit. Ndërsa paragrafi 1.1 i neni 26 të LMM-së përcakton kohëzgjatja për mbajtje e të drejtave të licencës për hulumtimin e mineraleve ndërtimore maksimumi mund të jetë një vit nga data e skadimit të licencës së hulumtimit. Sipas Bordit të KPMM-së, afati 1 vjeçar nga skadim i licencës në kohën e trajtimit veç se kishte kaluar, andaj për shkaqe objektive mbajtja e të drejtave nuk ka qenë e mundur.
8. Ndërsa, sqarohet se ndërmarrja e paditësit për zonën e njëjte që ka pasur licencë hulumtimi tashmë kishte marruar licencë të shfrytëzimit me numër 2105/ KPMM/2020 dhe në këtë kuptim vazhdimi i mbajtjes së licencës nuk ka qenë i arsyeshëm.
9. Në kuptim të nenit 27 par 1.2 LMM-së mbajtja e të drejtave në licencë të hulumtimit siç e parasheh ligji bëhet për një resurs mineral për të cilin nuk mund të zhvillohet menjëherë për shkak të kushteve të pa favorshme të tregut ose faktorëve të tjerë ekonomik që me arsye konsiderohen se janë të natyrës së përkohshme. Sqaron se ndërmarrja tashmë i kishte përfunduar të gjitha hulumtimet çka është edhe qëllimi i licencës së hulumtimit dhe kishte arritur që të marr licencën për eksploatimin apo shfrytëzimin e resursit mineral. E paditura KPMM, pretendimin e paditësit se vendimi është i kundërligjshëm se ka trajtim jo të barabartë, të pa anshëm dhe diskriminues e konsideron si të pa bazuar, gjeneral dhe pa asnjë dëshmi se me çfarë baze apo në raport me kë ekziston ky diskriminim apo trajtim i pa barabartë. Arsyeja e refuzimit të së drejtës për mbajtje të licencës nuk ka qenë mungesa e bordit mirëpo ka qenë kriteri se nëse i lëshohet e drejta një mbajtësi të licencës së hulumtimit e njëjta ka kohëzgjatje maksimale prej 1 viti nga skadimi i afatit të licencës. Licenca 1860 ka skaduar me datë 04.09.2020 dhe zgjatja do të mund të bëhej vetëm deri me datë 04.09.2021, kjo nuk ka qenë e mundur.

Provat e administruara

- 12 Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Kërkese për mbajtjen e të drejtave të licencës hulumtuuese, e dorëzuar në

KPMM me datë 27.08.2020, Licencë hulumtimi me numër 1860/KPMM/2018 të datës 03.10.2018, Vendimi i kundërshtuar me numër 408 me datë 23.02.2022 i KPMM-së, Raport për mbajtjen e licencës së hulumtimit me numër të referencës 005/KPMM me numër protokollit 4321 me datë 18.06.2021, Licenca paraprake e hulumtimit me numër 1515/KPMM/2015, Licencë shfrytëzimi me numër 2105/KPMM/2020, me datë 05.08.2020. Nga provat e administruara gjykata vlerësoj gjendjen faktike si ne vijim:

- 13 Paditësi Wallingford International Kosovo SH.P.K në KPMM kishte dorëzuar Kërkesën për mbajtjen e të drejtave të licencës hulumtuese, me nr. 6084 me datë 27.08.2020 për vazhdimin e Licencës së hulumtimit me numër 1860/KPMM/2018 të datës 03.10.2018, e cila do të skadoj me datë 04.09.2020, Mineralet Industrial, Përqeva Përendimoe Klinë, në sipërfaqe prej 50000.2 m2.
- 14 Në Raport për mbajtjen e licencës së hulumtimit me numër të referencës 005/KPMM me numër protokollit 4321 me datë 18.06.2021, Departamenti i Gjeologjisë i KPMM-së, ka vlerësuar se ndërmarrja i plotëson kushtet për vazhdimin mbajtjen e licencës. Bordi i KPMM-së, ka vlerësuar së kërkesa është parashtruar brena afatit, sepse ndërmarrja ka aplikuar me datë 27.08.2020 ndërsa licenca ka skaduar me datë 04.09.2020, mirëpo duke pas parasysh kohëzgjatjen e Licencës, sipas nenit 26.1 të LMMM, mbajtja e Licencës ka kohëzgjatje një (1) vit pas kalimit të afatit të Licencës, ka vlerësuar se ka kaluar afati ligjor pa u shqyrtuar për shkak të mungesës së Bordit.
- 15 Nga Licenca e shfrytëzimi me numër 2105/KPMM/2020, me datë 05.08.2020, konstatohet se paditësi Wallingford International Kosovo SH.P.K, ka marrë Licencë shfrytëzimi për Mineralet Industriale, në vendin e njëjtë Përqeva Përendimoe Klinë, në sipërfaqe prej 50000.2 m2.

Vlerësimi i gjykatës

- 16 Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e

përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

- 17 Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, Neni 26 par. 1 përcakton *KPMM mund t'i lëshojë një Licencë për Mbjajtjen e të Drejtave një personi i cili mban një Licencë aktuale dhe të vlefshme të Hulumtimit nëse dispozitat e kësaj Pjese IV e lejojnë këtë. Çdo Licencë për Mbjajtjen e të Drejtave: 1.1. nëse i lëshohet një bartësi të Licencës për hulumtimin e mineraleve ndërtimore, ka kohëzgjatje maksimale prej një (1) viti që nga skadimi i Licencës së tillë të hulumtimit; [...] 1.3. nuk mund të vazhdohet; dhe 1.4. duhet përcaktojë bazën sipas të cilës është lëshuar.*
- 18 Gjykata vlerëson se në kuptim të dispozitës ligjore të cituar më lart afati maksimal për vlefshmërinë e Licencës për hulumtimin e mineraleve ndërtimore, është një (1) viti që nga skadimi i Licencës së tillë të hulumtimit, dhe sipas paragrafit 1.3 nuk mund të vazhdohet. Prandaj vlerëson se e paditura KPMM në vendimin e kundërshtuar Nr. Prot:408 të datës 23.02.2022 me të drejtë ka vlerësuar se për shkaqe objektive licenca e hulumtimit nuk mund të vazhdojë, sepse ka kaluar afati ligjor maksimal i përcaktuar me dispozitat ligjore, në kohën e formimit të Bordit të KPMM-se.
10. Gjykata i vlerëson të bazuara pretendimet e paditësit se Bordit të KPMM-së, se është jashtë vullnetit të aplikuesit për mbajtje të licencës që të formoj Bordin e të Paditurës, që të shqyrtoj kërkesën dhe të nxjerrë vendime për aprovim apo refuzim për mbajtje të licencës, mirëpo rikujton se paditësi kishte në dispozicion mjete tjera ligjore të përcaktuara në Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjin për Konfliktet Administrative, për ta ndërmarrë veprime në rast se e paditura për çfarëdo arsye nuk shqyrton kërkesën e paditësit brenda afateve të caktuara ligjore. Prandaj paditësi nuk ishte i detyruar të priste formimin e Bordit të KPMM-së, që për pasoj kishte skadimin e afatit maksimal të parashikuar me ligj për vazhdim të licencës për hulumtim. Prandaj, kërkesa e paditësit për vazhdim të licencës së hulumtimit nuk ka mbështetje ligjore.

11. Pas shqyrtimit të padisë gjykata vlerësoj se masa për shtyrje të ekzekutimi i vendimit të paditurës, pas shqyrtimit përfundimtar të padisë hiqet sepse nuk plotësohen kushte për vazhdim nga nenin 22 i LKA-se.
12. Andaj bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1163/22, datë 28.08.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.